



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 6.5.2023

Nr: 454

Ora: 12:30

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT NR. 370 NGA PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË MBI KEQINFORMIMIN NGA DISA SUBJEKTE MEDIATIKE**

Sot më datë 6 Maj 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim denoncimin që i përket:

**KËRKUES:** Partia Demokratike

**OBJEKTI:** Kërkohet pasqyrimi nga OSHMA i emrit të drejtuesit të Partisë Demokratike sipas dokumenteve zyrtare

**BAZA LIGJORE:** Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neni 84, neni 84/1 dhe neni 85, i Kodit Zgjedhor, si dhe vendimi nr. 2, datë 30.01.2021, i Komisionit Rregullator, “Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të medias audio dhe audiovizive”, i ndryshuar

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

**KONSTATOJ:**

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, është administruar ankesë me nr. 4569 prot., datë 03.05.2023, me denoncues Partia Demokratike e Shqipërisë e përfaqësuar z. Enkelejd Alibeaj në cilësinë kryetarit të komanduar të kësaj partie. Ankesa është regjistruar në KQZ me nr. 370 ID të regjistrit të denoncimeve.

Nëpërmjet kësaj ankese pretendohet se disa subjekte mediatike i referohen z. Sali Berisha si kryetar i Partisë Demokratike.

Në përgjigje të këtij ankimi, KQZ filloi hetimin administrativ përkatës. Në kuadër të këtij hetimi administrativ ju kërkua Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), informacion në lidhje me sa është pretenduar në ankimin e Partisë Demokratike.

Në seancën publike të zhvilluar në datën 6 Maj 2023, përfaqësuesi në KQZ i kësaj partie pretendoi se në meritë të shqyrtimit të këtij ankimi nuk është kundërshtia mbi qëndrimet redaksionale të operatorëve radioteleviziv përkundrejt Partisë Demokratike. Kundërshtia është ndaj faktit që disa operatorë radiotelevizivë referojnë z. Sali Berisha si kryetar të subjektit zgjedhor Partia Demokratike, fakt i cili nuk është i vërtetë dhe si i tillë ai krijon konfuzion, krahas të tjerave edhe në përcaktimin e kohës radiotelevizive që përfiton Partia Demokratike në kuadër të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e datës 14 maj 2023.

Ndaj, bazuar mbi këtë natyrë kundërshtie, nuk është e nevojshme që AMA të disponojë mbi këtë pretendim të Partisë Demokratike dhe të pritët për përgjigjen nga ky institucion, pretendoi përfaqësuesi i PD-së në KQZ.

Duke vlerësuar këtë pretendimin, KQZ çmon se ai është i bazuar. Aktet e regjistrimit të Partisë Demokratike si subjekt zgjedhor, konkretisht, vendimi nr.27, datë 16.3.2023 i Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve dhe vendimi nr. 179, datë 18.3.2023 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Mbi zbatimin e vendimit nr. 27, datë 16.3.2023, të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve për regjistrimin e Partisë Demokratike si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”, tregojnë se ky subjekt zgjedhor drejtohet nga nënkryetari, z. Enkelejd Alibeaj, në cilësinë e kryetarit të komanduar të Partisë.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenin 84, nenin 84/1 dhe nenin 85, të Kodi Zgjedhor si dhe vendimin nr. 2, datë 30.01.2021, të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të medias audio dhe audiovizive”, të ndryshuar,

#### **V E N D O S:**

1. T’u kërkohet OSHMA-ve të referojnë z. Enkelejd Alibeaj në cilësinë e kryetarit të komanduar të Partisë Demokratike si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**